



# DITARI JAVOR

22 - 28 Prill

## VIZITA E MINISTRIT TË DREJTËSISË TË AUSTRISË Z. JOSEF MOSER

Takim me homologun Austriak, Dr. Josef Moser, për çështjet e rëndësishme si Reforma në Drejtësi dhe lufta kundër korrupsionit. Ministri Moser vlerësoi progresin dhe rezultatet konkrete në përmbushje të prioritetëve kyçe në kuadrin e procesit të hapjes së negociatave. Dr. Moser gjithashtu theksoi mbështetjen e Austrisë për Shqipërinë në rrugë e saj drejtë BE-së.

## CEREMONIA PËRMBYLLËSE E PROJEKTIT "TWINNING AGAINST CORRUPTION"

Së bashku me homologun austriak, z. Moser, u zhvillua ceremonia përmbyllëse e projektit "Twinning Against Corruption". Ky projekt shërben në luftën kundër korrupsionit, rezultatet e të cilit do të vijojnë të jenë pjesë e punës së Ministres së Drejtësisë.

## TAKIM ME Z.SCHMIDT, ANËTAR I BUNDESGUT GJERMAN

Takim me Z. Christian Schmidt, Anëtar i Bundestag-ut Gjerman dhe Dr. Johannes Dietrich, Zv. Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Tiranë për prezantimin e rezultateve të deritanishme të Reformës në Drejtësi dhe luftës kundër korrupsionit. Schmid, vlerësoi rezultatet e arritura dhe garanto mbështetjen e mëtejshme të Gjermanisë, veçanërisht në mbështetje të Reformës në Drejtësi.

## TAKIM ME Z. PETRY, ANËTAR I BUNDESAGUT GJERMAN

Takim me z. Christian Petry, Kryetar i Komisionit për Çështje të Bashkimit Evropian si dhe zëdhënës i grupit parlamentar të SPD-së për politikën evropiane, znj. Kerstin Villalobos, referente koordinuese e grupit parlamentar të SPD-së për politikën evropiane dhe znj. Maren Kneller, drejtuese e referatit për Bashkëpunimin Ekonomik, Ambasada Gjermane Tirane, për ecurinë e deritanishme për Reformën në Drejtësi dhe Luftën kundër Korrupsionit.

## TASK FORCA ANTIKORRUPSION

Task Forca Antikorrupsion rekomandoi 7 masa disiplinore pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë.

## DISKUTIM MBI KAPITULLIN E 23 TË LEGJISLACIONIT TË BE-SË DHE NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES ME FDUT

Diskutim me pedagog dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë, së bashku me nënkryetaren e Kuvendit znj. Hysi, nënkryetarin e Këshillit të Integritetit, z. Balla dhe Dekanin Prof. Dr. Artan Hoxha, për Kapitullin 23, të legjislacionit të BE, i cili parashikon Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore.

Marrëveshje bashkëpunimi me Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë për punësim, praktika dhe fellow-ship në institucionet shtetërore.